

COVID 19. REFLEKTIME

Habi Hoxha

VITI I, Master Shkencor, Marrëdhënie Ndërkombëtare, UMSH



“Lehtësia e padurueshme e qenies” ishte për të kuptuar se raporti mes “rëndesës” dhe “lehtësisë” në fakt nuk është gjithmonë një aspekt fizik. Kush nuk e ka përjetuar ndonjëherë ndjesinë e asaj “lehtësie” të padurueshme në mesin e stomakut?!

“*Nesër në betejë mendo për mua*”, Shekspiri dhe Javier Marias, në të provuarit përmes leximit të situatave dhe emocioneve të vërteta, që i dije, por nuk e dije që i dije apo Epilogut që të shoqëron në letrat e fundit me titull: “*Rreth tërë sa nuk ndodh dhe ndodh*” ku gjeta: “E thënë me dy fjalë, me fort gjasë, ne qëniet njerëzore përbëhemi nga tërë sa jemi, sikundërse edhe nga tërë sa nuk ishim, nga tërë sa është e vërtetueshme, e përcaktueshme dhe e ngulitur, sikundërse edhe nga tërë sa është e pasigurt, e papërcaktuar dhe e mjegullt, mbase përbëhemi në të njëjtën shkallë nga tërë sa ishte dhe tërë sa mund të ishte...”

Covid 19, na fali kohën, kuptimin e mirëfilltë të së cilës e nënvlerësojmë në përditshmërinë e botës që zgjedhim të “veshim”. Pastaj, janë kaq shumë gjëra për t’u lexuar, në letra romanesh, titra filmash, apo vargje poezish që i ke në mendje dhe i thërret për t’u gëzuar me veten:

*“Po motra Justi nesër ka me ardh,
dhe hire shërime mbi ne rishtas derdh,
e bardhë është jeta ka për t’thanë e bardhë,
veçse shikimi ynë është pakëz i verdhë.”*